



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 21616 prot.

Tiranë, më 3 . 6 .2024

V E N D I M

Nr. 54 datë 30.05.2024

**“PËR
KRIJIMIN E SHOQËRISË “TEDA TIRANË” SH.P.K., SI PERSON JURIDIK NË
PRONËSI TË BASHKISË TIRANË DHE MIRATIMIN E AKTEVE
TË THEMELIMIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, pika 1.6, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “d” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, vendimit nr. 717, datë 11.11.2022, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e “Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik” dhe Zhvilluesit të Zonës me Vendndodhje në Tiranë”, vendimit nr.169, datë 20.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Kontratës, Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Zhvilluesit, Bashkia Tiranë, Për Ndërtimin, Administrimin dhe Monitorimin e Funkcionimit të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Tiranë (TEDA TIRANË)”, si dhe Kontratës nr. 14590/2 prot, datë 17.04.2024 dhe nr 4950 prot., datë 17.04.2024, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkisë Tiranë “Për ndërtimin, administrimin dhe monitorimin e funksionimit të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, dhe Bashkisë Tiranë”, si dhe në vijim të memos nr. 20378 prot., datë 24.05.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Integritimit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik,

V E N D O S I :

1. Krijimin e shoqërisë me emërtimin tregtar “TEDA TIRANË” sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie, ndërtimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Tiranë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në bazë e për zbatim të tij, veçanërisht në bazë të VKM-së nr. 717, datë 11.11.2022, sipas kushteve dhe afateve të kontratës, të miratuar me VKM-në nr. nr.169, datë 20.03.2024.
2. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë “TEDA TIRANË” sh.p.k., sipas akteve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Shoqëria “TEDA TIRANË” sh.p.k. themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “TEDA TIRANË” sh.p.k. do të jetë 100 (njëqind) Lekë.
5. Bashkia e Tiranës është ortak i vetëm themelues, i cili zotëron 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë “TEDA TIRANË” sh.p.k. të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë.
6. Shoqëria “TEDA TIRANË” sh.p.k., fillimisht të këtë selinë qendrore në adresën Sheshi “Skënderbej”, Ndërtesa 2, 1001, Tiranë, Shqipëri.
7. Shoqëria “TEDA TIRANË” sh.p.k. të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë 35 vjeçare, me të drejtë ripërtëritje deri në 99 vjet, sipas përcaktimeve të VKM-së 169/2024.
8. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 100 (njëqind) lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2024 dhe Bashkia Tiranë transferon këtë shumë pranë kësaj Shoqërie, menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
9. Bashkia e Tiranës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë “TEDA TIRANË” sh.p.k. në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
10. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësojë Bashkinë e Tiranës, në cilesinë e ortakut të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për nënshkrimin e akteve të themelimit të Shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
11. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Tiranë, në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “TEDA” shp.k., me përjashtim të rasteve kur në statutin e shoqërisë parashikohet ndryshe.
12. Bashkia Tiranë i siguron shoqërisë “TEDA TIRANË” sh.p.k., nga inventari i saj mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
13. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Integritimit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO

